



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

2019:292299

Datë: 10.03.2021

Numri i dokumentit: 01584629

C.nr.654/2019

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Raif Fazliu, në çështjen juridike të paditësit N.N nga fshati Tërpezë, Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim bartës e përfaqëson Malsore Halili avokate në Viti, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Ekrem Shabani, zyrtar juridik pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, si dhe pagesën e udhëtimit, vlera e kontestit 2,257.20 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 08.03.2021 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I MIRATOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N nga fshati Tërpezë, Komuna e Vitisë, **DETYROHET** e paditura Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale e Arsimit që t'ia paguaj paditësit, shpërblimin jubilar, kompensimin për ushqim – shujtave për ditët e pranisë në punë, si dhe pagesën e udhëtimit shumat si vijon:

Në emër të shpërblimit jubilar 150%, të një page bazë, për përvojën e punës mbi 40 vite, shumën prej 688.50 €, kurse shumën prej 1,076 € në emër të ushqimit ditor për periudhën 18.04.2017 deri më 14.01.2020, apo për 538 ditë mësimore të mbajtura, si dhe në emër të pagesës së udhëtimit për 538 ditë shumën prej 406.70 €, apo gjithsej **2,171.20 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë me 17.12.2019 e deri në pagesën përfundimtare.

Shuma e sipërpërmendur paditësit do t'i paguhet në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II. Refuzohet** kërkesëpadia e paditësit N.N për shumën prej 86 euro, si e pa bazuar.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Vitisë, që t'ia kompensojë paditësit N.N shpenzimet e procedurës në shumën prej 270 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi N.N, nga Tërpeza Komuna e Vitisë, përmes të autorizuarës së tij, me datë 17.12.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, pagesën e udhëtimit, si dhe kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, pa e specifikuar shumën e përgjithshme.

Paditësi i punësuar në shkollën e mesme të lartë mikse (SH.M.L.M.) “Kongresi i Manastirit” në Pozheran me kontratë të punës në kohë të pacaktuar si mësimdhënëse, i punësuar para mbi 40 viteve më parë, me pagë mujore bazë prej 459 euro.

Në bazë të Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, përfaqësuesja e tij kishte deklaruar se kërkojmë shpërblim jubilar për paditësin, si dhe kompensimin e ushqimit-shujtave dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, në shumën e përgjithshme prej 2,257.20 €, duke e llogaritur edhe kamatën në shkallën prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar: 80 euro për kërkesën drejtuar të paditurës në procedurë administrative, 104 euro për përpilimin e padisë, 31 € për taksën për padi, 80 € për precizimin e padisë dhe 135 euro për një përfaqësim të avokates në seancë gjyqësore.

I autorizuari i paditurës në përgjigje në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se , kërkesat e tij nuk kanë bazë ligjore. DKA-ja dhe komuna nuk kanë të drejtë ligjore sipas Ligjit për Financat Publike të bëjë pagesën për paga dhe mëditje nga buxheti komunal. Pagat paguhen nga niveli qendror dhe në momentin kur të na ndahen mjete financiare nga niveli qendror, DKA-ja do ta bëjë pagesën e pagave jubilarë dhe beneficioneve tjera ashtu siç parashihen me Kontratën Kolektive nr.01B/2056, e datës 18.04.2017.

As Ligji i Punës nr.03/L-212, nuk i njeh këto të drejta dhe kompenzime për puntorët arsimorë, që t'i gëzojnë këto beneficione. Edhe Kontratën Kolektive për momentin nuk është duke e implemtuar-zbatuar Qeveria e Republikës së Kosovës, andaj këto kërkesa më tepër janë të nivelit qendror, të Ministrisë për Administratë Publike dhe të Ministrisë së Financave, se sa që janë obligime për komunat, duke shtuar se kjo kategori është ngarkesë buxhetore për komunat, në këtë rast edhe për DKA-të. Propozoj që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e pa bazuar.

Në seancën e datës 25.02.2021, përfaqësuesja e paditësit, në tërësi kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiës, si dhe parashtresës me të cilën e kishte precizuar padinë, duke i propozuar gjykatës që t'ia miratoj kërkesën e paditësit si të bazuar.

Ishte tërhequr nga propozimi për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, pasi që kemi të bëjmë me llogaritje të thjesht matematikore. Gjykatës i kishte dorëzuar precizimin e kërkesëpadiës, mbështetur në vërtetimet për ditët e pranisë në punë të paditësit, si dhe listën e pagave. Përgjigjen në padi e kishte konsideruar si jo relevante, me faktin se e paditura posedon apo jo mjete financiare, pasi që këtë të drejtë paditëses ia garanton Kontrata Kolektive e Arsimit nr. 01B nr. 2056, e datës 18.04.2017.

Kurse, përfaqësuesi i të paditurës Ekrem Shabani, e kishte kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit, duke e arsyetuar kundërshtimin, sepse kjo padi nuk ka bazë ligjore.

DKA-komuna nuk ka të drejtë ligjore sipas ligjit mbi ndarjen buxhetore në Republikën e Kosovës nr.06-L-133 neni 12 pika 4, ky ligj ndalon komunat që të paguajnë pagesat për paga dhe shujtat, pasi që pagat dhe shujtat janë çështje të nivelit qëndron të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

- Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të kësaj çështje, në kuptim të nenit 7.1 të LPK- së, ka administruar një sërë provash si: Kërkesën e paditësit nr.05-320/04-595, datë 26.11.2019, përgjigjen e të paditurit me numër të njëjtë sikur e kërkesës e datës 29.11.2019, Vërtetimin për paditësi nr.124/19, i datës 12.12.2019, të lëshuar nga SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit" në Pozheran, Vërtetimi për të njëjtin me nr.5/21, i datës 01.02.2021, i lëshuar nga SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit" në Pozheran , Regjistri i pagave i Ministrisë së Financave, certifikata e vendbanimit e datës 28.10.2020 dhe vërtetimin e transportit të udhëtarëve që veprojnë në territorin e Komunës së Vitisë, të nënshkruar dhe vulosur nga katër kompanitë operuese transportuese. Palët nuk kishin vërejtje në provat e administruara.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e paditësit, av. Malsore Halili, kishte thënë se nga provat e administruara baza juridike nuk është në asnjë çast kontestuese, andaj kishte propozuar që gjykata ta miratoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës DKA, jurist Ekrem Shabani, kishte mbetur pranë thënies të mëparshme, veçanërisht pranë përgjigjes në padi, duke kërkuar nga gjykata që

padinë ta refuzoj si të pa bazuar, pasi që DKA-ja, Komuna e Vitisë nuk janë përgjegjëse që nuk është zbatuar Kontrata Kolektive e vitit 2017, nga palët nënshkruese Ministria e Arsimit dhe SBASHK-u.

Po ashtu përgjegjëse janë Ministritë të Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë siguruar buxhet shtesë për këtë kategori të punëtorëve arsimor, për kompensimin e pagave jubilarë dhe beneficioneve tjera që parashihen me këtë kontratë. E kishte kontestuar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të procedurës siç janë kërkesa drejtuar të paditurës në procedurë administrative në vlerë prej 80 € dhe parashtresën për precizimin e padisë në vlerë prej 80 euro.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8, të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është vetëm pjesërisht e bazuar.

- Me leximin e kërkesës së paditësit nr. 05-320/04-595, datë 26.11.2019 dhe përgjigjen e të paditurit me numër të njëjtë të datës 29.11.2019, vërtetohet se paditësi i kishte shterur mundësitë që në procedurën administrative, ta realizoj kërkesën e tij, andaj për realizimin e të drejtës subjektive ju ishte drejtuar gjykatës.

- Me leximin e Vërtetimit për paditësin nr.124/19, i datës 12.12.2019, të lëshuar nga SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit" në Pozheran, gjykata ka vërtetuar se paditësi kishte punuar paraprakisht në gjimnazin "Kuvendi i Lezhës" në Viti, nga data 12.02.1979 deri me 15.01.1981, ndërsa tani në shkollën ku punon, gjendet nga data 01.01.2016 deri me datë 15.01.2020, kur edhe ishte pensionuar.

- Vërtetimi nr.5/21, i datës 01.02.2021, i lëshuar nga SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit" në Pozheran, tregon ka vërtetuar se paditësi në vitin shkollor 2016/17, ka 64 ditë mësimi, 2017/18, ka 207 ditë, 2018/19, ka 206 ditë mësimi 2019/20, ka 104 ditë mësimi, apo gjithsej sipas këtij vërtetimi paditësi kishte realizuar 581 ditë pune mësimore, ndërsa ka arritur përvojën e punës mbi 40 vite.

- Me leximin e Regjistrit të pagave të lëshuar nga Ministria e Financave, vërtetohet se paga bazë e paditësit ishte 459 euro.

- Me leximin e kalendarit të MASHT-it për vitin shkollor 2020-2021 për numrin e ditëve që mund të jenë në punë mësimdhënësit, i vërtetuar nga DKA-ja në Viti, konstatohet se një punëtor arsimor mund t'i realizoj gjatë vitit më së shumti 185 ditë mësimi, kurse edhe 10 ditë tjera jashtë mësimi.

- Me leximin e Certifikatës së vendbanimit për paditësin, e datës 28.10.2020, vërtetohet se ai ka vendbanimin në Tërpezë, andaj i njëjti për të vijuar në shkollën ku punon, ai duhet të udhëtoj në relacionin Tërpezë-Pozheran dhe anasjelltas, ku biletat e udhëtimit në këtë relacion kushtojnë 1 €, ndërsa 70%-shi i tyre llogaritet 0.70 €, ndërsa kur e shumëzojmë me 538 ditë të vijimit nga shtëpia-shkollë-shtëpi, na jep shumën për udhëtim prej 406.70 €. Lartësia e biletës vërtetohet nga vërtetimi i kompanive të transportit të udhëtarëve që veprojnë në kuadrin e komunës së Vitisë.

Me leximin e gjitha këtyre provave vërtetohet se paditësi kishte mbajtur 538 ditë pune, e që kur e shumëzojmë here 2 euro, na del shuma prej 1,076 €, kurse kur shumëzojmë 538 ditë të vijimit nga shtëpia-shkollë-shtëpi, të paditësit here 1 €, për çdo ditë, ndërsa 70%-shi i tyre llogaritet 0.70 €, na jep shumën e shpenzuar për udhëtim prej 406.70 €, ndërsa kur ia shtojmë paditësit 150%, e pagës bazë prej 459 €, nxjerrim shumën prej 688.50 €, e krejt në fund na del shuma e përgjithshme prej 2,171.20 €.

Gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës paditëse në shumë prej 86 euro si të pa bazuar, duke u bazuar në provën materiale, respektivisht në kalendarin e MASHT-it për vitin shkollor 2020-2021, për numrin e ditëve që mund të jenë në punë mësimdhënësit, i vërtetuar nga DKA-ja në Viti. Bazuar në këtë kalendar gjykata paditësit i ka pranuar ditë pune në mësim vetëm nga 185 ditë për vitin shkollor 2017/18 (e jo 207 ditë) dhe për vitin shkollor 2018/19 (e jo 206 ditë), siç ishin shkruar në vërtetimin nr.5/2021, datë 01.02.2021.

Po ashtu gjykata i ka pranuar paditësit ditë sa kishte udhëtuar nga shtëpia e tij në Tërpezë deri në vendin e tij të punës në Pozheran dhe anasjelltas, duke u bazuar në provën e njëjtë të lëshuar nga MASHT-i.

Gjykata konstaton se ndërmjet palëve nuk ishin kontestuese faktet se paditësi është i punësuar në shkollën dhe pozitën përkatëse siç i cekëm më lartë.

Gjykata vlerëson se paditësit i takon e drejta në realizimin të shpërblimit jubilar konform përvojës së tij të punës, bazuar në nenin 35.8, e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, kurse pagesa në udhëtim konform nenit 35, pika 5, ndërsa kompensimi në ushqim gjatë punës bazuar në nenin 35, pika 7, të kontratës së njëjtë.

Paditësi N.N, shumë prej 688.50 €, në emër të shpërblimit jubilar të 150%, të një page bazë, për përvojën e punës mbi 40 vite, 1,076 euro në emër të ushqimit ditor për 538 ditë pune, si dhe për 70%-shin e pagesës së biletave të udhëtimit për 538 ditë në relacionin Tërpezë-Pozheran dhe anasjelltas shumë prej 406.70 euro, apo gjithsej 2,257.20 euro.

Sa i përket pretendimit të autorizuarit të paditurës se komuna nuk ka të drejtë ligjore sipas ligjit mbi ndarjen buxhetore në Republikën e Kosovës nr.06-L-133 neni 12 pika 4, ku ky ligj ndalon komunitat që të paguajnë pagesat për paga dhe shujtat, pasi që pagat dhe shujtat janë çështje të nivelit qëndron të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj se paditësi është në punë dhe në sistemin e pagave dhe asgjë nuk humb deri sa të sigurohen mjetet financiare për këtë destinim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse Komuna –DKA-të, nuk kanë buxhete për ti paguar këto beneficione sipas Marrëveshjes Kolektive, këto pretendime janë të parëndësishme për gjykatën, andaj si të tilla nuk ka nevojë të arsyetohen.

Pra, kërkesa e paditësit sa i përket shpërblimit jubilar është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, ku sipas dispozitave të nenit 35.8, lidhur me nenin 35.9, Kontrata nr.01B-2056, datë 18.04.2017, sipas së cilës në nenin 35.8, thuhet se “Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit” në vlerë:

- për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë,
- për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë,
- për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë,
- për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë.

Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Ndërsa neni 35.5, e Kontratës thotë :*“Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*

Kurse në nenin 35, pika 7, të Kontratës së njëjtë thuhet: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit për një ditë të pranisë në punë është 2 €”.*

Pagat e shërbyesve civilë, sektorit të arsimit, të shëndetësisë e tjera, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, ku Komuna e Vitisë është organizatë buxhetore e nivelit lokal, po ashtu e paditura pranon edhe grande të ndryshme dhe të hyra vetanake. Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet SBASHK-ut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë (Qeveria e Republikës së Kosovës) prodhon efekte juridike nga data e lidhjes së saj me 18.04.2017, dhe e paditura si organizatë buxhetore e nivelit lokal është e detyruar t’ia paguaj paditësit shumë si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Neni 2. i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë në fushën e zbatimit të kontratës veç tjerash përcakton se dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunitat – DKA-të, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata miratimin e kërkesëpadisë së paditësit e ka bazuar në Ligjin e Punës nenet 10, 55 dhe 80, Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenet, 3, 22, 24, 31, 32, 49 dhe 54, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore neni 6 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë neni 35, pikat 5, 7 dhe 8.

Gjykata nuk ia ka pranuar palës paditëse shpenzimet e kërkuara lidhur me kërkesën e drejtuar DKA-së në Viti në procedurë administrative prej 80 €, pasi që kërkesa e tillë ka qenë e nevojshme në procedurën administrative, ndërsa gjykata në procedurën kontestimore nuk i pranon shpenzimet e shkaktuara në procedurën administrative, sikur që ka refuzuar ta kompensoj si shpenzim parashtresën për precizimin e padisë në shumë prej 80 €, me arsyetimin se kjo kërkesë është e njëjtë sikur padia dhe buron nga e njëjta, pra nuk nënkupton parashtresë tjetër, por bënë pjesë në kuadrin e padisë, që do të thotë se është obligim procedural i paditësit ta precizoj kërkesën e vetë (neni 453.1, i LPK-së).

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së, kurse për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452.1, të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve .

Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**

**C.nr.654/2019**

**Më: 08.03.2021**

**Gj y q t a r i,  
Raif Fazliu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e cila dorëzohet përmes kësaj gjykate.

